



Visar Kryeziu (kryetar)

Mobil: 078 840 74 01

E-Mail: visar.kryeziu@17shkurti.ch

Data: 06 Mars 2011

RAPORTI I KRYETARIT NË KUVENDIN E V-TË TË PËRGJITHSHËM TË SHOQATËS 17SHKURTI.CH

Të nderuar zonja dhe zotërinj

Më 28 Shkurt 2010 mora besimin e juaj që për një vit të plotë të jem kryetar i shoqatës 17shkurti.ch. Isha shumë i vetëdëshëm që kisha marr një përgjegjësi të madhe mbi vete. Muaj pas muaji dhe projekt pas projekti, viti kaloi me shumë sakrifica, munde e angazhime mirpo në të njëjtën kohë ishte edhe kënaqësi dhe vullnet. Qysh në fillim shoqata jonë mori punët me shumë seriozitet, duke pasë si qellim mbështetjen dhe ndihmën për bashkëqytetarët e Mireshit tonë. Nuk e kemi menduar asnjëherë se do të mund të realizonim kaq shumë projekte vetem brenda një viti, mirëpo falë punës dhe angazhimit të palodhshëm të kryesisë dhe falë ndihmës që keni bërë ju anëtarësi e nderuar u realizuan shumë projekte.

MBLEDHJET E KRYESISË

Shoqata kishte 13 anëtarë të kryesisë dhe kishim një numër të madh të mbledhjeve. Anëtarët e kryesisë i falenderoj për kohën e tyre që kanë gjetur për pjesëmarrje në mbledhje. Gjatë këtij mandati të kryesisë janë mbajtur gjithsej 21 mbledhje të kryesisë që do të thotë gati për çdo dy javë mbledhje. Mbledhjet zakonisht janë mbajtur të Dielave dhe çdo mbledhje ka zgjatur mesatarisht afër 3 orë. Kjo do të thotë gjat gjithë vitit mesatarisht 63 orë mbledhje.

NUMRI I ANËTARËSISË

Shoqata vitin e kaluar i kishte 118 anëtarë kurse në këtë vit ka rritur anëtarësinë e saj në 143 anëtarë të shoqatës. Megjithatë në krahasim me numrin e bahkfishatarëve tanë që jetojn në Zvicër ky numër i anëtarëve përsëri nuk është i knaqshëm. Me këtë rast iu kisha bërë një lutje që sa më shumë ti informoni të gjithë ata që ende nuk janë bërë anëtarë të shoqatës.

PROJEKTET E REALIZUARA

Gjatë këtij mandati të kryesisë janë realizuar 35 projekte. Në mesin e këtyre projekteve ende e papërfunduar është projekti „Një shtëpi për familjen e dëshmorit“. Ky projekt filloi në vjeshtë dhe për shkak të kohës së ftohtë shtëpia ende nuk është përfunduar mirëpo shtëpia është e ndërtuar dhe e mbuluar me kulm, pastaj janë vendosur edhe dritaret dhe dera e hymjes, kurse në këtë vit shpresojmë se do ti japim fund këtij projekti. Disa projekte tjera janë:

- Udhëtimi i të moshuarve nëpër Kosovë
- Java kulturore – Turnir i futbollit, ekspozite, gara në vrapim, manifestimi për dëshmoret
- Botimi i librit me titullin ”Për dikënd që jeto gjithmonë jeton”
- Dy aksione “shpëto një jetë njeriu”
- Inventari gadimores etj.

SPONZORËT

Për vitin 2010 kishim 26 sponzor të thjeshtë, 7 sponzor lokal, një sponzor përcjellës dhe një sponzor gjeneral. Gjetja e sponzorëve të rinjë nuk është e lehtë mirëpo është shumë e rëndësishme për shoqatën, jo vetëm që i ndihmon financiarisht por edhe vetë shoqatën e bënë më serioze në punë.

HARGJIMET E ANËTARËVE TË KRYESISË

Për dallim nga viti i kaluar në këtë vit ndoshta kemi pasur pak më pak hargjime nga xhepat e kryesisë, mirpo përsëri janë harxhime të mëdha. Në çdo aksion kemi qenë pjesmarrës të rregullt, si dhe gjithherë kur ishte nevoja kryesia kanë bërë hargjime nga gjepi i tyre me qëllim që konto e shoqatës të mos preket.

PIKËPAMJA IME PËR SHOQATËN NË TË ARDHMËN

Nëse dëshirojmë të kemi një shoqatë të shëndoshë, dhe të sigurtë une e shoh te arsyeshme që :

- a) Shoqata të qëndroj larg politikës
- b) Çdo kryetar i ardhshëm të jetë figurë uniteti dhe për të gjithë i pranueshëm
- c) Qëllimi dhe projektet e shoqatës të mos jenë favorizues i vetëm ndonje grupacioni
- d) Të ketë një arkatar të vyeshë dhe besueshëm
- e) Çdo hyrje dalje të jetë publike në uebfaqe të shoqatës
- f) Të ketë një agjendë të qartë të projekteve për të gjithë vitin

PËRFUNDIMI I MANDATIT NJË VJEQARË

Erdhi fundi i këtij mandati të kryesisë, dhe unë kam qenë i kënaqur me punën në përgjithësi të shoqatës. Gjatë tërë vitit kemi kaluar nëpër situata të ndryshme, mirpo të gjithë këtë e kemi bërë për të mirën e shoqatës. Unë e kam marrë këtë rol që të jem për një vit kryetar dhe pastaj të ia dorëzoj kryetarit të ardhshëm këtë detyrë. Dua ti falënderoj të gjithë bashkëshatarët e Mireshit që gjithmonë kanë pasur fjalë të mira për shoqatën, gjithashtu të gjithë ju anëtarët e shoqatës për mbështetjen financiare pa të cilët nuk do të mundeshim të realizojmë asgjë. Falënderim për të gjithë sponsorët, sponsorin përcjellës si dh sponsorin gjeneral. Falënderim të gjithëve atyre që na kanë dhënë ide të ndryshme, sygjerime apo kritika. Falënderim të veçant i takon kryesisë se shoqatës: Armendit, Qenanit, Necmedinit, Bahrijës, Muhamedit, Musait, Lulit, Sabitit, Agronit, Avniës, Burimit dhe Enverit. Një falënderim për mbështetje gjatë gjithë kohës kam për ish kryetarin Agron Zahiri, ku shoqata 17shkurti.ch pa Agronin do ta humbte kuptimin e saj.

Për të gjitha këto projekte, sukcesi dhe lavdata nuk më takojnë mua vetëm pse isha kryetar i deritanishëm, por me plotfuqinë e fjalës i takon juve anëtarësi e nderuar dhe kryesi e palodhshme.

SHOQATA NË TË ARDHMËN

Shoqata në të ardhmën do të kisha dashur ta shihja, të bashkuar, me një imazh pozitiv dhe e dashur për të gjithë bashkëshatarët tanë pa dallim.

Me respekt



Visar Kryeziu

Kryetar i shoqatës 17shkurti.ch